



Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 12.2 shkronja d), nenit 40.2 nen c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.3/L-040, Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Nenit 6 dhe paragrafit 6 të nenit 9 të Ligjit Nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023. Ligjit Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal. Nenit 40 nen piken 3 të Statutit të Komunës së Klinës, me kërkesën e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim me nr. prot. 01Nr.451-14145/2023, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e IV-të të rregullt të mbajtur më datën: 28.04.2023, mori këtë :

V E N D I M

Për bartjen dhe shpërndarjen e mjeteve të mbetura nga të hyrat vetanake nga viti 2022 në vitin 2023

1. Miratohet vendimi për bartjen dhe shpërndarjen e mjeteve të mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2022 në vitin 2023 në shumë prej **976,793.04 €**.

1.1 Mjetet buxhetore si në pikë 1 të këtij vendimi, shuma prej 402,738.43 euro janë mjete të mbetura të pa shfrytëzuara nga të hyrat vetanake për vitin 2022 sipas planifikimit buxhetor, ndërsa shuma prej 574,054.61 euro janë mjete nga tejkalimi i të hyrave vetanake për vitin 2022.

2.. Shuma si në pikën 1 të këtij vendimi shpërndahet në programe dhe nen-programe buxhetore dhe në kategori ekonomike të shpenzimeve si në vijim:

Mallra dhe Shërbime në shumën prej **113,709.54 €**;
Shpenzimet komunale në shumën prej **35,183.50 €**;
Shpenzime kapitale në shumën prej **804,900.00 €**;
Subvencione dhe transfere shumën prej **23,000.00 €**.

Në kategorinë mallra dhe shërbime :

Infrastruktura Rrugore (18018), shuma prej **88,736.84 €**;
Planifikimi urban dhe inspeksion (66395), shuma prej **17,000.00 €**.
Shërbimet e shëndetësisë primare (74050), shuma prej **2,972.70 €**;
Shërbimet Sociale (75586), shuma prej **5,000.00 €**.

Arsyetim: Bartje e obligimeve të pashlyera si dhe shpenzimet e krijuara nga dëmet e shkaktuara nga vërshimet, kryesisht furnizimet me zhavor.

Në kategorinë e shpenzimeve komunale :

Drejtoria për Buxhet e Financa (17518), shuma prej **25,000.00 €**;
Administrata e arsimit (92090) shuma prej **10,183.50 €**.

Arsyetim: Bartje e obligimeve të pashlyera për shkak të rritjes së çmimit tek shpenzimet komunale.

Në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve

Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (47018) shuma prej **20,000.00 €**;
Administrata e arsimit (92090) shuma prej **3,000.00 €**.

Arsyetim: Kërkesa për bartje bëhet për shkak të rritjes së subvencionimit në bujqësi në bashkëfinancim me fermerë.

Në kategorinë e shpenzimeve kapitale:

Planifikimi urban dhe inspeksion (66395), në projektet:

“Bashkëfinancim me donatorë”, kod (48267), shuma prej 250,000.00 €;
“Ndërtimi i stacionit të autobusëve”, kod (48112), shuma prej 69,900.00 €;
“Asfaltimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore në Dersnik-Dolac”, kod (48121), shuma prej 90,000.00 €;
“Rregullimi i shtratit të lumit Drini i Bardhë”, kod (49553), shuma prej 10,000.00 €;
“Asfaltimi i rrugëve lokale në Ranoc-Leskoc”, kod (49591), shuma prej 50,000.00 €;
“Asfaltimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore Videjë-Paskalicë-Krushevë e Madhe”, kod (50662), shuma prej 15,000.00 €;
“Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore në Drenovcë”, kod (47156), shuma prej 40,000.00 €;
“Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore në Jashanicë-Jelloc-Resnik-Pogragjë”, kod (49602), shuma prej 80,000.00 €;
“Ndërtimi i liqenit akumulues për furnizim me ujë të pijes”, kod (49606), shuma prej 30,000.00 €;
“Rregullimi i shtratit të lumit Klina në drejtim të Grykës së Jarinës”, kod (50683), shuma prej 100,000.00 €.

Infrastruktura Rrugore (18018), në projektet:

“Rregullimi dhe zgjerimi i parqeve në Klinë”, kod (52511), shuma prej 20,000.00 €;
“Sanimi i gropave të rrugëve me asfalt në Resnik, Leskoc etj.”, kod (52516), shuma prej 50,000.00 €;

Arsyetim: Në vitin 2022 dhe në vijim inflacioni global e ka rritur edhe koston e shpenzimeve. Për këtë arsye në vitin 2022 kemi kontrata që nuk janë realizuar sipas planifikimit buxhetor dhe kanë mbetur të kryhen në këtë vit si dhe disa projekte për shkak të infolacionit nuk kemi arritur t'i kontraktojmë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorin për Financa Ekonomi dhe Zhvillim.

4. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, sipas rregullore (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullore (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

5. Me këtë vendim njoftohen: MPL, Kryetari i Komunës, Drejtoria e FEZH, Zyra për Informim dhe Arkivi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 451-1456/2023
Klinë, më 02.03/2023



Kryesuesi,
Fadil Gashi